

RAPORTI VJETOR

2023



PËRMBAJTJA

- **Parathënie..... 3**
- **Përmbledhje ekzekutive.....4**
- **HYRJE..... 5,6**
- **Projektet e implementuara përgjatë 20237**
- **Shërbimet e ofruara përgjatë 2023.....8**
 - Shërbimet ditore për fëmijë e prindër..... 9,10
 - Shërbimet e pajisjeve ndihmëse.....13
 - Shërbime juridike dhe tjera..... 14
- **Trajnime dhe punëtori.....15-18**
- **Intervenimet avokuese dhe lobuese..... 19-26**
- **Të tjera.....27,28**

PARATHËNIE

HANDIKOS është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Studimet tregojnë se në shoqëritë e zhvilluara, ofrimi i përkujdesjes shoqërore konsiderohet si një aspekt i rëndësishëm i rolit të shtetit, prandaj përfitimet nga përkujdesja janë pjesë e të drejtave të individit, qasje kjo që anasjelltas ofron suksesin ose dështimin e përkujdesjes ndaj personave me aftësi të kufizuara, e që për shumë arsye është vendimtare për mirëqenien e shoqërisë.

Sipas Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, gjendja e tanishme e personave me aftësi të kufizuara nuk përmbushë realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Andaj, si rrjedhojë, të gjitha subjektet janë përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte e cila arrihet vetëm duke eliminuar çdo lloj pengese dhe barriere që krijon vështirësi në respektimin e parimit të mos-diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, e theksojmë se institucionet e Kosovës kanë akoma shumë punë dhe përpjekje për të bërë.

HANDIKOS ka vazhduar të punojë në ngritjen e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara, duke lobuar dhe avokuar për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe me kushte të barabarta për të gjithë.

Synimet tona kryesore gjatë 2023-ës kanë qenë të fokusuar në katër (4) objektiva:

-Avokimi dhe lobimi drejt mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në përfshirjen e tyre në legjislacionin e Kosovës;

-Vazhdimësia në ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, të cilat janë primare dhe më se të nevojshme por që ende mbesin një sfidë;

-Ngritja e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara mbi të drejtat e tyre dhe personelit të HANDIKOS.

-Shtyrja përpara e përfshirjes së Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë sfida e barriera në vendin tonë, ndër të cilat ende mbesin: qasja, edukimi, punësimi, mirëqenia si dhe respektimi dhe avancimi i të drejtave të tyre, duke u bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare. Kur përmendim sfidat, gjithsesi këtu duhet përmendur në veçanti edhe sfidat me të cilat HANDIKOS ballafaqohet, duke u bazuar 100 % në projekte, pa asnjë mbështetje të përhershme sidomos kur kemi të bëjmë me shërbimet të cilat ende nuk ofrohen nga institucionet vendore. Dhe kjo pjesë është vështirësuar edhe më tej sidomos përgjatë këtij viti.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesë e integruar e shoqërisë në tërësi dhe atyre duhet t'u ofrohet mundësia drejt pavarësisht i ndividual, ku përmes përvojës, talenteve dhe kapaciteteve të tyre të kontribuojnë në zhvillimin e shtetit tonë.

Afrim Maliqi

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor – 2023 paraqet një pasqyrë përmbledhëse të të arriturave të HANDIKOS përgjatë vitit, në kuadër të programeve të implementuara. Të dhënat e raportuara janë të bazuara në të arriturat e HANDIKOS-it në implementimin e projekteve të mbështetura nga donatorë vendorë dhe atyre të huaj. Përmes shërbimeve të ofruara përgjatë një viti për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe prindër/familjarë të tyre, HANDIKOS ka vazhduar misionin e saj për të avancuar situatën e aftësisë së kufizuar në vend

Përgjatë një viti, HANDIKOS ka ofruar shërbime direkte për 333 fëmijë me aftësi të kufizuara në shtatë komuna të Kosovës, 34 prindër të tyre dhe 32 të rritur me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës. Njëkohësisht janë ofruar mbi 700 shërbime të pajisjeve ndihmëse për qytetarë nga e gjitha Kosova. HANDIKOS gjatë vitit 2023, ashtu sikurse në vitet e kaluara, përmes këshillave ligjore ka ndikuar në përmbushje të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara. Përgjatë një (1) viti, 170 këshilla të tilla janë ofruar për personat me aftësi të kufizuara në mbarë Kosovën, përfshirë takime mbështetëse, referime, vizita në shtëpi, shërbime për jetesë të pavarur etj.

HANDIKOS ka vazhduar edhe këtë vit si prioritet lobimin dhe avokimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe kërkesat drejt institucioneve në rregullimin e shumë problematikave me të cilat përballen në përditshmëri. Angazhimi ynë ishte i fokusuar në avokimin për politika e veprime konkrete që do ndikonin në përmirësimin e jetesës së komunitetit tonë, kështu duke theksua shtyrjen e procesit të përfshirjes së Konventës së OKB'së për të drejtat e njeriut, personave me aftësi të kufizuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për çka edhe sivjet kemi realizuar takime e punëtori të shumta me akterë institucional e organizata për ta jetësuar këtë qëllim. Ky proces ka mbetur ende në Parlamentin e Kuvendit të Kosovës, si shkak i mos arritjes së 2/3 të votave për miratim.

Bashkëpunimi i ngushtë që HANDIKOS ka vazhduar ta mbajë me organizatat e shoqërisë civile, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat ndërkombëtare, institucionet lokale dhe qendrore, shoqërinë, dhe vetë komunitetin e aftësisë së kufizuar, ka ndikuar dukshëm në funksionimin e përditshëm, adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara si dhe avancimin e situatës së tyre në shoqëri. HANDIKOS vazhdon të punojë për një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara.

HYRJE

○ HISTORIKU

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) është themeluar më 1983, me iniciativën e z. Halit Ferizi, kryetar i atëhershëm i shoqatës dhe më vonë lider i lëvizjes së aftësisë së kufizuar në Kosovë, së bashku me një grup të qytetarëve me aftësi të kufizuara. Objektivë kryesore ishte “përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë”, përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit.

Prej themelimit e deri në ditët e sotme, HANDIKOS është përkrahur nga një numër i konsiderueshëm i organizatave ndërkombëtare dhe vendore të cilat i kanë mundësuar HANDIKOS ekzistencën për më shumë se dy (2) dekada. Në fillimet e saj, HANDIKOS mbështetje të madhe ka pranuar nga: “Handicap International”, “OXFAM”, Agjencia Finlandeze FIDIDA, Qeveria e Finlandës, Ambasada e Finlandës, Organizata Italiane “Onlus Wamba-Athena”, “Onlus Roberto Bazzoni”, “Save The Children”, “UNICEF”, Agjencia Evropiane për ndërtim dhe rindërtim, mbështetës të cilët kanë mundësuar misionin dhe vizionin e HANDIKOS.

Pavarësisht mungesës së statistikave vendore për numrin dhe prevalencën e aftësisë së kufizuar në vend, në databazën e saj, HANDIKOS numëron më shumë se 18,000 anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të moshave, gjinive dhe etnive të ndryshme në mbarë Kosovën. HANDIKOS ka ofruar shërbime sociale në komunitet dhe shtëpi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familjarët e tyre. Për më tepër, përgjatë gjithë kësaj përvoje, HANDIKOS është orientuar gjithashtu edhe në avokim dhe lobim për njohje dhe respektim të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë duke intervenuar në vetëdijen e shoqërisë si dhe në akte ligjore dhe nënligjore.

HANDIKOS ndërvite ka modeluar dhe ofruar sete të ndryshme të programeve rehabilituese të cilat kanë mbështetur gjithë personat me aftësi të kufizuara në vend dhe familjet e tyre. Të gjitha këto, janë ofruar përmes programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi - RBB, program ky të cilin HANDIKOS e ofron që nga viti 2002 në Prishtinë, Podujevë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Vushtrri, Pejë, Istog, Mitrovicë; në kuadër të të cilave, sete të shumta të shërbimeve dhe teknikave avokuese janë implementuar. Së fundmi HANDIKOS në kuadër të programit të RBB-së është duke modeluar qasjen bio-psiko-sociale në të gjitha shërbimet e saj, qasje kjo e cila sheh personin në qendër nga këndvështrime të ndryshme.

Me gjithë veprimet që janë ndërmarrë viteve të fundit, personat me aftësi të kufizuara në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme në të gjitha aspektet jetësore të cilat u pamundësojnë atyre realizimin e të drejtave njerëzore dhe një jetese të dinjitetshme siç është reflektuar edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe në aktet e tjera ligjore të vendit.



Bazuar në hulumtimet e fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, konsiderohet se rreth 15 % e popullsisë së botës kanë të paktën një aftësi të kufizuar. Në Kosovë, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë figurojnë rreth 93.288 persona me aftësi të kufizuara.

Përgjatë vitit 2023, HANDIKOS ka zhvilluar Strategjinë e re katër vjeçare, me qëllim të punës së përcatuar çdoherë në parimet dhe objektivat strategjike.

VIZIONI

Shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara .

MISIONI

Të arrijë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre .

PROJEKTET QË HANDIKOS KA IMPLEMENTUAR PËRGGJATË 2023

- ◁ HANDIKOS for Child Rights në bashkëpunim me Save the Children dhe financuar nga SIDA- the Swedish International Development Cooperation Agency
- ◁ Shërbimet e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (RBB) për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara janë fuqizuar dhe të Qëndrueshme mbështetur nga UNICEF në bashkëpunim me USAID;
- ◁ Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara drejtë jetesës së pavarur dhe përfshirja e tyre në jetën socio- kulturore, mbështetur nga Ministria e Drejtësisë;
- ◁ Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel Lokal, Nacional dhe Regional mbështetur nga Bashkimi Evropian;
- ◁ Ofrimi i shërbimeve për të rritur me aftësi të kufizuara, mbështetur nga Komuna e Prishtinës;
- ◁ Fuqizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, mbështetur nga UNMIK - United Nations Mission in Kosovo.
- ◁ Mbështetja në përmirësimin e kushteve të punës në objekt, nga Later Days Sant Church of Jesus Christ óLDS
- ◁ Ofrimi i shërbimeve të pajisjeve ndihmëse, mbështetur nga Raiffeisen Bank

SHËRBIMET E OFRUARA PËR FËMIJË, TË RRIUR DHE PRINDËR

HANDIKOS përgjatë vitit 2023 ka vazhduar të ofrojë shërbime për fëmijët, prindërit/kujdestarët, tërriturit e qytetarët e tjerë.

Shërbimet e ofruara për komunitet në kuartalin e parë të vitit janë ofruar duke u bazuar në modelet që HANDIKOS ka pilotuar dhe programuar ndër vite, duke ofruar kështu mbështetje holistike me bazë bio-psiko-sociale si dhe duke u orientuar në pavarësimin e mbështetjen e fëmijëve, prindërve të tyre e të rriturve me aftësi të kufizuara.


HANDIKOS përgjatë implementimit të shërbimeve të ofruara në Programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, me mbështetje të projekteve që ka implementuar përgjatë vitit 2023, të financuara nga donatorët vendor dhe të huaj, ka arritur të mbështesë **333 fëmijë** me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës dhe gjashtë komuna tjera, përmes mbi 10 mijë seancave individuale, **34 prindër** përmes 523 seancave psikologjike, si dh për 32 të rritur, me 408 seanca individuale, 20 veta të përfshirë në kamp rehabilitimi dhe 50 të rritur të përfshirë në dy ekskursione.

Përpos kësaj, HANDIKOS ka organizuar përgjatë krejt vitit edhe aktivitete të ndryshme rekreative për fëmijë, prindër të tyre dhe të rritur me aftësi të kufizuara.


Shërbimet kyçe të ofruara përgjatë këtij viti kanë mbështetur zhvillimin holistik të fëmijëve me theks në shkathtësitë ditore, zhvillimin kognitiv, fizik dhe atë emocional.

Shërbimet sociale të ofruara përgjatë 2023-ës në HANDIKOS në qendër dhe terren janë:

- Ø Psiko-social (për fëmijë dhe të rritur)
- Ø Fizioterapeutik (për fëmijë dhe të rritur)
- Ø Psikologji
- Ø Logopedi
- Ø Seanca grupore javore



SHËRBIMET PËR FËMIJË NË PRISHTINË



SHËRBIMET PËR PRINDËR NË PRISHTINË



LOGOPEDI



- 17 fëmijë
- (6V – 11D)

AKTIVITETE REKREATIVE



- 5 aktivitete
- 34 fëmijë

ARTI EBRU

-16 PRINDËR-



FIZIOTERAPI

- 268 të rritur-



PSIKO-SOCIALE

-140 të rritur-




KAMP REHABILITIMI

-20 përfitues-



HANDIKOS ka vazhduar vlerësimin e rregullt të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipi multidisiplinar i HANDIKOS duke vënë fëmijën në fokus si dhe duke analizuar perspektivën e prindërve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve (kur është aplikuar). Bazuar në rezultatet e vlerësimit, janë përpiluar plane individuale të intervenimit për çdo fëmijë përfitues, përderisa ri-shikimi i tyre është bërë në baza tre (3) mujore duke aplikuar procesin e ri-vlerësimit në të gjitha fushat e zhvillimit.

Të dhënat nga vlerësimi bazë i fëmijëve dhe ato nga ri-vlerësimi i fundit i realizuar në dhjetor 2023 tregojnë rezultate të kënaqshme të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara përgjatë një (1) viti, pavarësisht sfidave me të cilat janë ballafaquar fëmijët përfitues, ofruesit e shërbimeve si dhe prindëritë përfshirë në këtë proces.





-Momente nga seancat e shërbimeve sociale për fëmijët-



SHËRBIMET E PAJISJEVE NDIHMËSE

HANDIKOS ka vazhduar të mbështesë personat me aftësi të kufizuara në Kosovë edhe përmes ofrimit të pajisjeve ndihmëse për lëvizje, shërbim ky i cili ka mundësuar dhe kontribuar në pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, për më tepër ka kontribuar direkt edhe në përmbushjen e misionit tonë.

Përgjatë një viti, kemi arritu që në mënyrë direkte të mbështesim me **731 pajisje ndihmëse** personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarët e tjerë që kanë pasur nevojë nga e gjithë Kosova. Kryesisht, përgjatë këtij viti janë shpërndarë karroca standarde, karroca tualeti, karroca speciale, paterica dhe shëtitore.

Çdo përfitues, fillimisht është vlerësuar, përmes inventarëve vlerësues që HANDIKOS posedon, inventarë të cilët pasqyrojnë nevojat e personit për përdorimin e pajisjes ndihmëse, si dhe specifikacionet e llojit të pajisjes ndihmëse dhe përmasave të saj. Pajisja ndihmëse është montuar dhe përshtatur me nevojat e përdoruesit të saj, përderisa të njëjtit janë trajnuar në përdorimin e shëndetshëm të pajisjes ndihmëse, mirëmbajtjen e shëndetit përgjatë përdorimit të pajisjes ndihmëse e gjithashtu edhe mirëmbajtjen e vetë pajisjes.


	Vajza	Djem	Gra	Burra
	135	158	179	259
Nen Total	293	438		
TOTAL	731			



SHËRBIME JURIDIKE DHE TË TJERA

HANDIKOS ka vazhduar të ofrojë shërbimin e këshillimit juridik për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në vend edhe përgjatë vitit 2023, të cilat janë kryesisht relevante me rastet e diskriminimit, mohimit të të drejtave bazë të njeriut dhe parregullsi të tjera të cilat kanë të bëjnë me vështirësitë e personave me aftësi të kufizuara në gëzimin e benefiteve të garantuara me ligj, siç është vlerësimi jo i drejtë që po u bëhet personave me status Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga ana e Komisionit Mjekësor.

HANDIKOS ka ofruar 170 këshilla juridike për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe familjarët e tyre, përfshirë në padi, takime mbështetëse, referime, vizita në shtëpi, shërbime për jetesë të pavarur etj.



Trajnime dhe punëtori

HANDIKOS si çdoherë ka punuar ngushtë me komunitetin që përfaqëson në ngritjen e kapaciteteve në fusha të ndryshme, përfshirë këtu fëmijët, të rriturit, prindërit, si dhe organizatat e tjera partnere, me të cilat bashkërisht synohet të avancohet situata e personave me aftësi të kufizuara në vend.

Në kuadër të projekteve të ndryshme, kemi realizuar takime e punëtori me akterë relevantë të cilët kanë rol kyç në çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët, të rriturit, organizata të personave me aftësi të kufizuara, organizata të tjera nga shoqëria civile, Qendra për Punë Sociale, shkolla etj.

Nga gjysma e vitit 2023, Grupi Avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara Hëna ka vazhduar në mënyrë aktive të punojë në fuqizim dhe ngritje të kapaciteteve të rreth 200 fëmijëve me aftësi të kufizuara në tetë komuna të Kosovës; Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Drenas e Suharekë.

GRUPI HËNA

TRAJNIME

PUNËTORI

HARTIM I
DOKUMENTE
VE

SESIONE
INFORMIMI



AKTIVITETET QË JANË REALIZUAR NGA MUAJI KORRIK E DERI MË TANI JANË:

Organizimi i takimeve informuese të Grupit të drejtuar nga fëmijët "Hëna" në 7 komuna- 80 pjesëmarrës

Trajnim për 30 fëmijët e Grupit "Hëna" mbi të drejtat e tyre dhe avokim- 17 fëmijë më aftësi të kufizuara

Trajnim për 30 fëmijët e Grupit "Hëna" mbi Konventën e të drejtave të fëmijëve, me theks të veçantë nënën e diskriminimit
trajnim mbi organizimin e fushatave sensibilizuese dhe Hapësirë Qytetare



Punëtorja e grupit Hëna për zhvillimin e Strategjisë trevjeçare të avokimit dhe planit të veprimit- 25 fëmijë më aftësi të kufizuara

Përpilimi i dokumentit/analizës në perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe qëndrueshmërisë mjedisore

Punëtori për të zhvilluar Vlerësimin e Kapaciteteve të Organizatës- për staf të HANDIKOS- it- 25 pjesëmarrës ngastafi i HANDIKOS

Takim me Avokatin e Popullit dhe publikimi i buletinit informativ



Në këto aktivitete kanë marrë pjesë rreth 100 fëmijë të G.A "Hëna" nga 7 komuna në të cilat funksionon grupi (Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Drenas dhe Suharekë).

Trajnime/punëtori dhe aktivitete tjera

- Punëtorja për ngritjen e kapaciteteve për personat me aftësi të kufizuara
- Trajnim dy ditor lidhur me Shtrirjen dhe fuqizimin e Aftësisë së Kufizuar.

Rritja e mundësive që OPAK të marrin pjesë në dialog me qeverinë.

*Projekti ka kontribuar në procesin e avokimit për përfshirjen e konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në kushtetutën e Kosovës.

*Projekti kishte vazhdimisht takime me përfaqësues të institucioneve nga niveli qendror dhe lokal për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, sidomos sa i përket edukimit, qasjes dhe punësimit.

*Projekti vazhdon të mbështes, kontribuoj dhe bashkëpunoj me Këshillin Nacional të Aftësisë së Kufizuar.

Rritja e njohurive dhe aftësive të OPAK dhe rrjeteve të tyre për avokim, marrëdhënie mediatike dheqasje.

Projekti ka arritur të realizoj trajnime në 5 komuna lidhur me avokimin dhe përdorimin e legjislacionit aktual në avokim.

Partneritetet e fuqizuara midis Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) dhe rrjeteve të OPAK në Kosovë.

Projekti ka mbështetur ZQM për të aplikuar në instrumentin e BE për mbështetje profesionale,

SOCIEUX+ lidhur me hartimin e strategjisë dhe planit nacional të veprimit për personat me aftësi të kufizuara.

Projekti në bashkëpunim me ekspertët nga SOCIEUX+ dhe ZQM ka mbështetur zhvillimin e punëtorisë një ditore për vlerësimin zbatimit të Planit paraprakë të Veprimit.

Projekti në bashkëpunim me ekspertët nga SOCIEUX+ dhe ZQM ka realizuar punëtoritë lidhur me hartimin e Planit të ri të Veprimit 2024-2026.

Punëtori dhe trajnime për ndërtimin e kapaciteteve organizative dhe qeverisjen demokratike të OPAK-ve dhe rrjeteve të tyre.

Partnerët e Projektit nga Finlanda (Kynnys) kanë realizuar një punëtori dy ditore lidhur me fuqizimin egrave në avokim.

Trajnime për ndërtimin e kapaciteteve organizative dhe qeverisjen demokratike të OPAK dhe rrjeteve të tyre. Vetëm gjatë vitit 2023 janë zbatuar 3 takime mbështetëse nga Finlanda.

Koordinimi i nismave të përbashkëta nga OPAK

Projekti përmes takimeve koordinuese ka fuqizuar partneritetin në mes të OPAK, sidomos ato nganiveli nacional duke bërë të mundur fuqizimin e avokimit për interesa të përbashkëta.

GRUPI AVOKUES I PRINDËRVE

Trajnim me qëllim të dhënies së njohurive për rolin e avokimit, si dhe sfidat me të cilat janë përballur GrP gjatë avokimit në nivel lokal.

Trajnim për GrP, me qëllim të avancimit të njohurive të komunikimit dhe avokimit cilësore, trajnimi është fasiluar nga një eksperte vendore.

Gr P që nga themelimi ka mbajtur gjithsejmbi 25 takime avokues përfshirë nivelin lokal si në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Gjilan, Prishtinë.



TRYEZË ME AVOKATIN E POPULLIT

Qëllimi i tryezës ishte thellimi i bashkëpunimit ndërmjet OJQ-së dhe institucionit, me qëllim nxitjen e respektimit të të drejtave.

KAMPI I REHABILITIMIT

Kampi tre ditor i rehabilitimit për të rriturit me aftësi të kufizuara, i cili u zhvillua në SPA “NënaNaile”. Gjatë këtij kampi pjesëmarrësit ndoqën edhe ligjërata për të drejtat e njeriut.

BURSA PËR STUDENTË

Universiteti i Prishtinës, për herë të parë ndau bursa tëplota për të gjithë studentët me aftësi të kufizuara, ku bursa vjetore ishte 450 euro për çdo student.

ZHVILLIMI I STRATEGJISË TE ORGANIZATËS

Punëtorja për hartimin e strategjisë pesëvjeçare të organizatës HANDIKOS, për periudhën 2023/2028.

MURALI

Murali, me temë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

LOBIMI DHE AVOKIMI

HANDIKOS përgjatë vitit 2023 ka punuar në fushën e avokimit dhe lobimit për të avancuar situatën e personave me aftësi të kufizuara në vend, e me theks të veçantë për të promovuar të drejtat e barabarta dhe jetë të dinjitetshme për të gjithë. Përgjatë një (1) viti, HANDIKOS përmes takimeve, komunikimit nëpërmjet mediave e fushatave direkte e virtuale ka adresuar të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara, qasjen, edukimin dhe pjesëmarrjen.

Si një ngjarje tashmë e përvjetshme, edhe këtë vit është shënuar 1 Marsi- Dita ndërkombëtare e përdoruesve të karrocës, e cila është karakterizuar me një aktivitet që për qëllim ka pasur thirrjen për përmirësim të qasjes infrastrukturore, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të lartë institucional, me qëllim të vetëdijësimit për veprim në zbatimin e të drejtave të qytetarëve. Ngjarja është përcjellur me mesazhe të cilat portretizojnë jetesën e përdoruesve të karrocës në Kosovë, me moton **Ne lëvizim ndryshe, por jemi të barabartë!**. Ngjarja është ndjekur nga mediat dhe e gjithë kjo ka arritur një shikueshmëri prej mbi 100.000 njerëz nëpër rrjete sociale.

(Takimi me kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti)



(Takimi me presidenten e Kosovës, znj. Vjosa Osmani)



(Takimi me kryeparlamentarin e Kosovës, z. Glauk Konjufca)



Eventi - E ardhja inspiruese

Grupi Avokues i Fëmijëve me aftësi të kufizuara Hëna, përmes një eventi të madh në Prishtinë promovoi punën një vjeçare në ngritjen e kapaciteteve, avokimit direkt dhe indirekt drejt institucioneve për zbatimin e të drejtave të plota, si dhe ndarjes së storieve të suksesit mes fëmijëve.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin mbi 200 pjesëmarrës, përfshirë fëmijë, prindër të tyre, të rritur, partnerë, donatorë, përfaqësues institucionesh e miq të tjerë.





Shënimi i 3 Dhjetorit – Dita Ndërkombëtare e Përdoruesve të Karrocës

Me rastin e shënimit të kësaj date shumë të rëndësishme, HANDIKOS ka zbuluar muralin me figurën e qytetarit Faruk Kukaj në Prishtinë, kështu për të simbolizuar të drejtat dhe qytetarin aktiv, si dhe për të promovuar dukshmërinë sa më të madhe të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin kryetari i komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama si dhe Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, poashtu anëtarë, prindër e qytetarë të tjerë, duke arritur kështu prezencë të madhe në media dhe audiencë, që padyshim ka ndikuar në përcëimin sa më të madh të mesazhit tek shoqëria.



Përtej këtij aktiviteti, HANDIKOS në Qendrën e Resurseve me lokacion në Veternik ka organizuar një event, kështu duke mbledhur fëmijë, prindër të tyre e anëtarë të rritur, por edhe përfaqësues të institucioneve lokale për të prezantuar të arriturat e organizatës në fushën e avokimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, si dhe të shërbimeve sociale .



Për të pasqyruar sakrificat, sifdat, vullnetin e mbështetjen e nënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në mënyrë ceremoniale HANDIKOS ka hapur ekspozitën Buqetë Zembrash, e punuar me piktura të Artit Ebru, me shumë përkushtim nga 16 nëna.



Ndërkaq përmes paraqitjeve mediatike, në përditshmëri, HANDIKOS në bashkëpunim me Grupin Avokues të Prindërve dhe atë të të Rriturve në Prishtinë, ka ngritur zërin e ka avokuar më tepër për të drejtat e PAK, kështu në fund të vitit duke ngritur një fushatë më të madhe mediatike dhe intensive - disajavore, për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e mëdha me të cilat po ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në Kosovë në mungesë të shërbimeve sociale dhe të pambështetura prej institucioneve lokale dhe qendrore.



HANDIKOS rol të madh edhe në aktivitetet avokuese tjera:

- Ø Avokimi për qasje në Komunën e Prishtinës;
- Ø Pjesëmarrja në Këshillin për Persona me Aftësi të Kufizuar
- Ø Shpërndarja e pajisjeve ndihmëse dhe trajnimet për stafin e qendrave të HANDIKOS;
- Ø Amandamenti i Kushtetutës për përfshirjen e Konventës për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Ø Zhvillimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të HANDIKOS 2024 2028
- Ø Bashkëpunimi me UP dhe Universitete tjera vendore dhe ndërkombëtare
I idhur me qasjen dhe pajisjet ndihmëse teknologjike për studentët me aftësi të kufizuara

SFIDAT AKTUALE

- Ø Projekt Kodi doganor dhe i akcizave;
- Ø Energjia elektrike;
- Ø Ligji gjithëpërfshirës;
- Ø Udhëzimi administrativ për qasje;
- Ø Vlerësimi i personave parapelgjik dhe tetrapelgjik nga komisionet vlerësuese, ndryshimi i rregullores;
- Ø Qëndrueshmëria e shërbimeve sociale
- Ø Padi të tjera;

Publikime:

- 1. *Analizë e kuadrit ligjor nga perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe qëndrueshmërisë mjedisore***

Linku: <https://bitly.ws/3qIGv>

- 2. *Plani Strategjik për Avokim për Grupin Hëna***

Linku: <https://bitly.ws/3qIGP>

- 3. *Buletini i Grupit Hëna***

Linku; <https://bitly.ws/3qIFY>

- 4. *Plani i Veprimit për Avokim me Grupin HËNA***

Linku: <https://bitly.ws/3qIFt>

- 5. *Raporti i vlerësimit të qasshmërisë në ndërtesat e 5 komunave të Kosovës***

Linku: <https://bitly.ws/3qIET>



Rr. "Nekibe Kelmendi", nr. 80, Prishtinë; Telefoni: +383 49 377 655

Email: handikos@handi-kos.org; Webfaqja: <http://handi-kos.org/>



